



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

**MIRATOHET
KRYETARI:**

Formati i Deklaratës së objektivitetit, kompetencës dhe pa anësisë

Audituesi _____

Viti i deklarimit _____

Bazuar në ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe në Manualin e Auditimit, Kodin e Etikës dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm të, deklaroj se:

1. Gjatë gjithë veprimtarisë time si auditues në njësinë e auditimit të brendshëm të Bashkia Lezhe , strukturë dhe përbërje organike të Bashkisë Lezhe , ku unë jam i punësuar, do të veproj dhe do të zbatoj detyrat e mia në mënyrë profesionale dhe të pavarur, duke dhënë gjykimin tim objektiv, të paanshëm dhe me kompetencë si auditues. Për këtë nuk do të angazhohem në asnjë detyrë tjetër brenda subjektit publik ku unë jam i punësuar ose jashtë subjektit publik, kur ky angazhim cënon objektivitetin, kompetencën dhe paanësinë.
2. Do të ruaj integritetin tim personal dhe profesional në realizimin e detyrës, duke vepruar në mënyrë korrekte dhe në përputhje me parimet e auditimit të brendshëm duke mbajtur parasysh vetëm interesin publik. Nuk do të hyj në asnjë marrëdhënie individuale me drejtuesit dhe punonjësit e njësisë që do të auditoj nëse kjo do të çënojë, dobësojë apo kompromentojë parimin e paanësisë dhe objektivitetin në angazhimin tim gjatë kryerjes së detyrës si auditues. Çdo rrethanë që mund të influencojë negativisht në realizimin me cilësi të auditimit dhe sipas gjykimit tim, përbën konflikt interesi, do të bëhet e njohur te drejtuesi i njësisë së auditimit përpara se të fillojë detyra e auditimit në një angazhim auditimi ku unë do të jem pjesëtar i grupit të auditimit, me qëllim që të merret në konsideratë prej tij.
3. Do të respektoj; kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 114/2012 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe në Manualin e Auditimit, si dhe Kodin e Etikës dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Lezhe , si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që lidhen me zbatimin e procedurave të auditimit në organizatën(Bashkinë Lezhe) ku unë do të kryej veprimtari audituese.
4. Do të respektoj kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe të ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” të ndryshuar , si dhe të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar duke synuar në parandalimin e çdo konflikti interesi që mund të shkaktohet nga pranimi i dhuratave që mund të influencojnë në pavarësinë dhe integritetin tim si auditues. Në asnjë

rast, nuk do shfrytëzoj postin (pozitën) zyrtar për përfitime personale. Do të parandaloj çdo rrethanë që paraqet risk ose cënon pozicionin tim si auditues.

5. Në veprimtarinë time si auditues do të respektoj dispozitat ligjore që lidhen me konfidencialitetin në ushtrimin e detyrës. Gjithë informacioni i vënë në dispozicionin tim, nga subjekti që unë do të auditoj, do të përdoret vetëm për qëllimet e auditimit dhe do të raportohet sipas kërkesave dhe standardeve profesionale.
6. Do të përdor metoda dhe teknika auditimi cilësore të tilla që të garantoj nivelin më të lartë të mundshëm të cilësisë së punës. Për këtë, do të zbatoj Manualin e Auditimit të Brendshëm, metodika, metodologji, udhërrëfyes dhe procedura të cilat më japin mundësi për të kryer detyrën me efektivitet dhe efikasitet.
7. Do të respektoj detyrimin tim për të mbajtur nivel të mirë profesional dhe gjatë gjithë kohës, do të zbatoj standarde të larta profesionale me qëllim që të kryej detyrat e mia me përkushtim, duke bashkëpunuar me anëtarët e grupit (kolegët) dhe komunikuar me eprorët sipas shkallës hierarkike.
8. Do të hartoj programe auditimi dhe do të kryej auditime në mënyrë profesionale i çliruar nga çdo formë paragjykimi si dhe do të jem i përgatitur për të renditur gjetjet që përmbajnë gabime materiale, shpërdorime, abuzime, apo fenomene me karakter vjedhje e korrupsione për të adresuar në mënyrë profesionale të gjitha rekomandimet që sigurojnë përmirësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të organizatës. Rastet që përbëjnë vepra penale do të raportoj në strukturat përkatëse të specializuara sipas rrugës zyrtare dhe hierarkike.
9. Do të mundohem të implementoj veprimtari audituese, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të auditimit të vendeve të Bashkimit Europian.
10. Gjatë përdorimit të informacionit si auditues, do të ndjek dhe zbatoj instruksionet mbi sigurinë e informacionit, si dhe ato për kufizimet e tij.
11. Në ushtrimin e detyrës si auditues sjellja ime do të reflektojë besim, do të jetë konfidenciale dhe me besueshmëri tek organizata (Institucioni publike) ku unë do të angazhohem si auditues dhe tek drejtuesi i njësisë së auditimit ku unë jam i punësuar.
12. Duke vlerësuar se besimi i publikut dhe respekti për punën e audituesit është kryesisht rezultat i aftësive, punës në grup, gjykimit dhe punës profesionale, do të garantoj që raportet dhe deklaratat e hartuara prej meje, të konsiderohen të plota e të besueshme nga palët e treta dhe publiku.
13. Garantoj se zotëroj kualifikimin e nevojshëm dhe do ta vë tërësisht në zbatim, përvojën time profesionale për të realizuar veprimtari audituese me efektivitet. Garantoj se kam kompetencën që plotëson nevojat e fushës dhe kompleksitetin e detyrës audituese.
14. Do të jem i angazhuar për përditësimin e aftësive të mia në përputhje me zhvillimin profesional, brenda fushës së auditimit, përveç mundësive që do të më ofrojë punëdhënësi.

Audituesi

(Emri/ Mbiemri/ Firma)

Data _____

(data/muaji/viti)

.....